

VENDIM
Nr. 797, datë 9.11.2016

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT
“ASFALTIM I RRUGËVE DHE TROTUARIT PRANË STADIUMIT “QEMAL STAFI”,
TIRANË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, të ndryshuar, dhe të neneve 5, pika 1, 20 dhe 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Asfaltim i rrugëve dhe trotuarit pranë stadiumit “Qemal Stafa”, Tiranë”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Tiranë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë “truall” dhe “ndërtesë”, me një vlerë të përgjithshme prej 183 626 878 (njëqind e tetëdhjetë e tre milionë e gjashtëqind e njëzet e gjashtë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e tetë) lekësh.

4. Vlera totale e shpronësimit, prej 183 626 878 (njëqind e tetëdhjetë e tre milionë e gjashtëqind e njëzet e gjashtë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e tetë) lekësh, të përballohet nga llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2016, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Urban.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.

7. Pronarët e listës që i bashkëlidhen këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Tiranë.

8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit, të miratuar, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.

9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin që të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit, si dhe kalimi i pronësisë, për pasuritë e shpronësuara.

10. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Urban, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

LLOGARITJET PARAPRAKE PËR PASURITË QË PREKEN NGA PROJEKTI “ASFALTIMI I RRUGËVE
DHE TROTUARIT PRANË STADIUMIT “Q. STAFA”, TË MIRATUAR NË KËSHILLIN TEKNIK TË
BASHKISË TIRANË ME VENDIMIN NR. 8/7, DATË.2.6.2016

Nr.	EMËR	ATËSI A	MBIEMËR	Zona kadast	Nr. i pasurisë	SIP. përgj. tr. (m²)	SIP. tr. prekur (m²)	Çmimi i truallit lek/m²	SIP. Obj. prekur (m²)	Çmimi Obj. lek/m²	Vlera në lekë	Konfirmimi i ZVRPP-së, Tiranë
1	22 bashkpr.		Grori, Matoshi, Dervishi, Rama, Karaj, Shabaj, Kotoni, Boçi, Nikolla, Global Constr.	8160	6/380	6979.0	1710.00	66969			114,516,990	Shkr.nr. prot.10117/1, datë 18.4.16
2	Azem		Neza	8160	6/132	116.0	116.00	66969	348.00	29245	17,945,572	Shkr.nr. prot.10117/1, datë 18.4.16
9	9 bashkpr.		Tartari, Hoxha, Nepravishta	8160	6/370	1251.6	559.00	66969			37,435,671	Shkr.nr. prot.10117/1, datë 18.4.16
11	12 bashkpr.		Grori, Dervishi,	8160	6/388	567.0	205.00	66969			13,728,645	Shkr.nr. prot.21101/2, datë 13.7.16
						SHUMA	2590,00		348,00		183.626.878	

Shënim:

1. Për truallin, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja 89, datë 3.2.2016.
2. Për ndërtesat, vlerësimi është bërë sipas VKM nr. 138, datë 23.3.2000 (i ndryshuar) dhe sipas çmimeve mesatare të zërave të punës për qytetin e Tiranës, të vëna në dispozicion me shkresën nr. prot. 647/2, datë 15.3.2016 nga EKB-ja.